



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

RREGULLORE

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË AKTUARIT TË AUTORIZUAR

Miratuar me Vendimin e Bordit nr.37, datë 27.03.2019

Neni 1

Objekti

Kjo Rregullore ka për objekt përcaktimin e rregullave të rinovimit të licencës së aktuarit të autorizuar.

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë të pikës 5, të nenit 222, të Ligjit nr. 52/2014, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Neni 3

Rinovimi i licencës

Konsiderohet kërkesë për rinovim licence, kërkesa që depozitohet në Autoritet në harkun kohor nga 6 muaj para përfundimit të afatit të licencës deri në 6 muaj pas përfundimit të këtij afati.

Kur kërkesa depozitohet në Autoritet pas 6 muajve nga mbarimi i afatit të licencës paraardhëse, atëherë kjo kërkesë do të konsiderohet si kërkesa për licencë të re.

Neni 4

Kriteret për rinovimin e licencës

Aktuari i autorizuar i cili kërkon të rinovojë licencën duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:

- a. Të ketë kryer trajnimet e vazhdueshme profesionale, brenda afatit 3 vjeçar të vlefshmërisë së licencës duke grumbulluar të paktën 40 kredite.
Trajnimet e vazhdueshme profesionale dhe njohja e krediteve bëhet sipas parashikimeve në rregulloret përkatëse për organizimin e aktiviteteve të formimit profesional dhe për njohjen e krediteve të formimit profesional në vazhdimësi.
- b. Të mos ketë detyrime të papaguara në afat.
- c. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për ndonjë vepër penale.
- d. Të mos ketë masa administrative apo disiplinore të marra ndaj tij.

Neni 5

Paraqitja e dokumentacionit për rinovimin e licencës

Aktuari i Autorizuar, për rinovimin e licencës së tij, depoziton në Autoritet së bashku me kërkesën edhe dokumentat si më poshtë:

- a. Cv dhe fotokopje të dokumentit të identifikimit;
- b. Dokument që vërteton se nuk ka detyrime të papaguara në afat, të lëshuara nga administrata tatimore;
- c. Formular vetëdeklarimi të gjendjes gjyqësore.

Neni 6

Shqyrtimi i kërkesës për rinovim

1. Struktura përgjegjëse për rinovimin e licencës së aktuarëve koordinon me strukturat përgjegjëse për trajnimet profesionale dhe për njohjen e krediteve, në lidhje me regjistrin e AMF-së për trajnimet e vazhdueshme profesionale dhe njohjen e krediteve.

2. Autoriteti, pas plotësimit të dokumentacionit të plotë nga ana e kërkuesit për rinovim licence,
brenda 2 muajve miraton ose refuzon rinovimin e licencës.
3. Rinovimi i licencës për ushtrimin e veprimtarisë së aktuarit të autorizuar shoqërohet me pagesën e tarifës për llogari të Autoritetit, sipas rregullores në fuqi, për përcaktimin e elementëve të përlllogaritjes dhe nivelet e tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura, si dhe procedurat e arkëtimit dhe rakordimit të tyre.

Neni 7

Shfuqizime

Rregullorja nr. 57, datë 28.04.2016 “Mbi trajnimet e vazhdueshme profesionale dhe rinovimin e licencës së aktuarit të autorizuar” shfuqizohet me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.